

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenin 24 dhe nenin 65, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/ 16 gusht 2010), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2019 miratoi:

## **RREGULLORE PËR REGJISTRIN E KREDIVE**

### **KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

1. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme “Banka Qendrore”) mban dhe administron Regjistrin e Kredive të Kosovës (në tekstin e mëtejme “Regjistri i Kredive”) për të mbledhur dhe shpërndarë informacionin e kredive mes institucioneve financiare për qëllime të përmirësimit të cilësisë së kredive dhe të realizimit të funksionit mbikëqyrës të Bankës Qendrore.
2. Kjo Rregullore rregullon mbledhjen dhe përdorimin e informacionit të kredive përmes Regjistrit të Kredive.

#### **Neni 2**

#### **Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet për institucionet financiare të licencuara nga Banka Qendrore për të qenë ofrues të kredive, duke përfshirë të gjitha bankat dhe institucionet mikro-financiare si dhe ato institucione financiare jobankare dhe siguruesit e licencuar për t’u marrë me aktivitete të veçanta kreditore.

#### **Neni 3**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përcaktuara në Nenin 3 të Ligjit Nr.04/L-093 për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare (në vijim: Ligji për Bankat) dhe/ose siç përcaktohen në vijim për qëllimin e kësaj rregullore:
  - 1.1. **Kredi** - nënkupton çdo huamarrje apo zotim të drejtpërdrejtë apo të tërthorët për dhënien e parave në këmbim të të drejtës për kthimin e shumës së dhënë dhe të papaguar dhe të pagesës së interesit apo detyrimeve të tjera për atë shumë, çdo shtyrje të afatit për pagimin e një borxhi, çdo garancion bankar/sigurimi ose letër kredie e lëshuar dhe çdo zotim për të siguruar të drejtën e pagesës së një shume të parave. Termi “kredi” gjithashtu përfshin bilancin e mbitërhequr nga llogaria, ose mbitërheqjet.

Termi “kredi” nuk do të përfshijë kreditë ndërbankare, blerjet e letrave me vlerë të borxhit të qeverisë dhe blerjet e të gjitha letrave me vlerë të borxhit në tregun sekondar.

- 1.2. **Ofrues i kredive** - nënkupton çdo bankë të licencuar, çdo institucion mikro-financiar të licencuar, një institucion financiar jo-bankar të licencuar për aktivitet të veçantë kreditor, ose një kompani të sigurimit të licencuar për aktivitet të veçantë kreditor.
- 1.3. **Person fizik** - nënkupton një individ.
- 1.4. **Të dhëna personale** - nënkupton çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik;
- 1.5. **Të dhëna të ndjeshme personale** - nënkupton të dhëna personale që zbulojnë origjinën etnike ose racore, pikëpamjet politike ose filozofike, përkatësinë fetare, anëtarësimin në sindikatë ose çdo e dhënë për gjendjen shëndetësore ose jetën seksuale, çfarëdo përfshirje në ose heqje nga evidencat penale ose të kundërvajtjeve që ruhen në pajtim me ligjin. Karakteristikat biometrike, gjithashtu, konsiderohen si të dhëna personale të ndjeshme, nëse këto të fundit mundësojnë identifikimin e një subjekti të të dhënave në lidhje me cilëndo nga rrethanat e lartpërmendura në këtë nën-paragraf;
- 1.6. **Entitet juridik** - nënkupton çdo organizatë, shoqëri tregtare, korporatë, degë e shoqërisë së huaj tregtare në Kosovë, zyra e përfaqësisë së shoqërisë së huaj tregtare në Kosovë, ndërmarrjet publike sipas ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
- 1.7. **Shoqëri tregtare** - është term i përgjithshëm që do të thotë dhe përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo të një ligji tjetër siç është përcaktuar në nenin 5 paragrafi 3 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.
- 1.8. **Korporatë** - nënkupton një Shoqëri Aksionare ose Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të regjistruar në Kosovë.
- 1.9. **Degë e shoqërisë së huaj tregtare** - nënkupton subjektin e regjistruar në Kosovë për ushtrimin e veprimtarisë së ligjshme ekonomike nga një Shoqëri e Huaj Tregtare e themeluar sipas një ligji të një juridiksioni jashtë Kosovës.
- 1.10. **Të dhëna të entitetit juridik** - nënkupton çdo informacion në lidhje me një entitet juridik.
- 1.11. **Raport i kredive** - nënkupton çdo komunikim me shkrim apo elektronik të çfarëdo informacioni nga Regjistri i Kredive që ka lidhje me ekspozimin dhe historinë kreditore të një personi fizik apo entiteti juridik.
- 1.12. **Kredimarrës** - nënkupton një person fizik apo entitet juridik që ndërmerr një obligim kredie.
- 1.13. **Bashkë-kredimarrës** - nënkupton një person fizik ose një entitet juridik i cili merr përsipër një detyrim kreditor me një person fizik ose një entitet juridik tjetër.

- 1.14. **Garantues** - nënkupton një person fizik ose entitet juridik i cili merr përsipër detyrimin ligjor të kthimit të kredisë në rast të dështimit të kthimit të kredisë nga kredimarrësi parësor.
- 1.15. **Subjekti i të dhënave** - nënkupton një person fizik apo një entitet juridik në lidhje me të cilin informacioni i Regjistrimit të Kredive është mbledhur dhe hartuar në një raport të kredive. Subjekti i të dhënave po ashtu referohet edhe si një klient - ai që ka përdorur shërbime të kredive ose që ka aplikuar për kredi, përfshirë kredimarrësit dhe bashkë-kredimarrësit, garantuesit dhe personat e tjerë të lidhur.
- 1.16. **Pëlqim** - nënkupton shprehje e lirë e vullnetit të dhënë lirisht, specifik, të informuar dhe të qartë të subjektit të të dhënave nëpërmjet të cilit ai ose ajo, me një deklarament ose me një veprim të qartë pohues, shpreh pëlqimin e tij/saj për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të.
- 1.17. **Përpunim** - nënkupton çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi.
- 1.18. **Informacion negativ** - nënkupton informacion lidhur me vonesat në kthimin e kredisë nga kredimarrësi si dhe çdo formë tjetër shkeljeje të detyrimeve në lidhje me kredinë.
- 1.19. **Informacion pozitiv** - nënkupton informacion lidhur me kthimin me kohë të kredisë nga ana e kredimarrësit si dhe çdo formë tjetër të respektimit të detyrimeve lidhur me kredinë.
- 1.20. **Udhëzim** - nënkupton një rekomandim me shkrim të lëshuar nga Banka Qendrore që ka aplikim të përgjithshëm dhe është i detyrueshëm në tërësinë e tij dhe drejtpërdrejt i zbatueshëm.
- 1.21. **Ekspozim** - nënkupton çdo aktivë ose zë jashtë-bilancor i gjendjes, duke përfshirë pa kufizim ndonjë kredi apo zotim direkt ose indirekt për pagim të parasë në shkëmbim të së drejtës për kthim të shumës së paguar dhe të mbetur dhe për pagesën e interesit apo, shpenzimeve të tjera që lidhen me këtë shumë, çdo shtyrje të datës së pagimit të borxhit, çdo garancion apo letër-kredi të lëshuar, letra me vlerë të borxheve dhe forma të ngjashme të kreditimeve apo zotimeve për kreditime të dhëna nga banka për klientin, si dhe aksionet, pjesëmarrjen në kapital dhe llojet tjera të investimeve në një person juridik nga banka;
- 1.22. **Të dhëna alternative** - nënkupton të dhëna tjera mbi aftësinë paguese të kredimarrësit të cilat janë relevante në procesin e kredidhënies, duke përfshirë por jo kufizuar në të dhënat mbi pagesat e shërbimeve komunale, tatimeve, taksave, rrymës, telefonisë si dhe të dhënat nga gjykatat.

## KAPITULLI II – FUNKSIONI I REGJISTRIT TË KREDIVE DHE NATYRA E INFORMACIONIT TË KREDIVE

### Neni 4

#### Funksioni i regjistrimit të kredive

1. Regjistri i Kredive funksionon si një sistem i centralizuar brenda Bankës Qendrore për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit të kredive mes ofruesve të kredive.

2. Regjistri i Kredive mbledh dhe shpërndan informacione pozitive dhe negative për subjektet e të dhënave.
3. Informacionet e kredive raportohen drejtpërdrejt në Regjistrin e Kredive nga ana e ofruesve të kredive. Ofruesit e kredive janë përgjegjës për saktësinë dhe plotësinë e informacionit të raportuar në Regjistrin e Kredive në bazë të kësaj Rregulloreje, dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për këtë qëllim.
4. Banka Qendrore nuk mban përgjegjësi për mënyrën e përdorimit dhe vlerësimit të informacionit të kredive, edhe në rastet kur ai është i pasaktë, i paplotë apo i vonuar si rrjedhojë e raportimit të tillë nga ana e ofruesve të kredive.

## **Neni 5**

### **Mbledhja e lejueshme dhe e ndaluar e informacionit të kredive**

1. Në përputhje me këtë Rregullore, për çdo kredi Regjistri i Kredive mund të mbledhë dhe të mbajë së paku të dhënat në vijim:
  - 1.1. Të dhënat e përgjithshme të identifikimit duke përfshirë por jo kufizuar në: emrin e subjektit ose subjekteve të të dhënave, numrin personal të regjistrimit, vendin e lindjes/regjistrimit dhe adresën kryesore të banimit/operimit;
  - 1.2. Të dhënat specifike për kredi duke përfshirë por jo kufizuar në: numrin e identifikimit unik, produktin kreditor, shumën e lejuar, datat relevante, shumën e mbetur (aktive), historinë e kthimit dhe kolateralet përkatëse;
  - 1.3. Të dhënat e klasifikimit kreditor siç rregullohet nga Banka Qendrore; dhe
  - 1.4. Të dhënat publike si dhe të dhëna alternative që përcaktohen të jenë relevante nga Banka Qendrore.
2. Regjistri i Kredive nuk mund të mbledhë ose të raportojë asnjë nga të dhënat e mëposhtme për subjektet e të dhënave:
  - 2.1. Të dhënat e ndjeshme personale; dhe
  - 2.2. Të dhënat për kreditë e kthyera pas pesë vitesh nga data e kthimit të plotë, dhe të dhënat për kreditë e fshira nga bilanci pas shtatë vitesh nga data e fshirjes.

## **KAPITULLI III – PËRGJEGJËSITË E OFRUESVE TË KREDIVE**

### **Neni 6**

#### **Marrja e Pëlqimit nga subjekti i të dhënave**

1. Ofruesit e kredive duhet të marrin pëlqimin nga subjekti i të dhënave në harmoni me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Përmes pëlqimit të subjektit të të dhënave, ofruesi i kredive autorizohet të bëjë hulumtimin, përpunimin dhe raportimin e informacionit dhe të dhënave të përcaktuara sipas kësaj rregulloreje.
2. Ofruesit e kredive duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë marrjen e pëlqimit nga subjekti i të dhënave sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Përpunimi i të dhënave personale do të bëhet në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Ofruesit e kredive duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm për të siguruar që subjektet e të dhënave e kuptojnë efektin e dhënies së pëlqimit.
5. Ofruesit e kredive nuk duhet të ndërmarrin veprime që në mënyrë të vetëdijshme t'ia fshehin subjektit të të dhënave kuptimin e pëlqimit ose kërkesën për pëlqim.
6. Pëlqimi i subjektit të të dhënave do të jetë i vlefshëm për gjithë kohën e vlefshmërisë së marrëveshjes së kredisë, përfshirë marrëveshjen e ripërtëritë apo ndryshimin e kushteve të marrëveshjes ekzistuese.

#### **Neni 7**

##### **Raportimi i informacionit të kredive dhe standardi i raportimit**

1. Të gjithë ofruesit e kredive janë të obliguar të raportojnë në Regjistrin e Kredive të gjitha aplikacionet për kredi dhe kreditë e lëshuara për klientët e tyre në përputhje me kushtet e udhëzimit përkatës të lëshuar nga Banka Qendrore.
2. Ofruesit e kredive do të ofrojnë në Regjistër të Kredive informacione të kredive që janë të sakta, të plota dhe me kohë.
3. Nëse në çdo kohë një ofrues i kredive konstaton se informacioni i dhënë nuk është i saktë, i plotë, ose me kohë, ofruesi i kredive duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të siguruar informacionin e saktë, të plotë dhe me kohë, dhe ta dorëzojë atë në Regjistër të Kredive.
4. Në qoftë se pas ndërmarrjes së të gjitha hapave të arsyeshëm ofruesit e kredive, nuk mund të prodhojnë informacion të saktë, të plotë dhe me kohë, ofruesi i kredive duhet ta njoftojë menjëherë Regjistrin e Kredive.

### **KAPITULLI -IV - PËRDORIMI I INFORMACIONIT TË KREDIVE**

#### **Neni 8**

##### **Qasja në raportet e kredive**

1. Subjektet e mëposhtme janë të lejuar për të pasur qasje në raportet e kredive nga Regjistri i Kredive:
  - 1.1. Ofruesit e kredive;
  - 1.2. Subjektet e të dhënave, që mund të kenë qasje në raportet e tyre të kredive;
  - 1.3. Banka Qendrore, në përputhje me këtë Rregullore dhe ligjet, rregulloret apo udhëzimet e tjera; dhe
  - 1.4. Subjektet e tjera, që janë të autorizuar me ligj.

#### **Neni 9**

##### **Përdorimi i raporteve të kredive**

1. Subjektet që lejohet të kenë qasje në informacionin e kredive:

- 1.1. do t'i përdorin raportet e kredive vetëm për qëllimin për të cilin janë marrë dhe për asnjë qëllim tjetër; dhe
  - 1.2. nuk do t'i shpërndajnë raportet e kredive tek palët e treta, përveç nëse kërkohet me ligj apo me urdhër të gjykatës kompetente.
2. Ofruesit e kredive janë të detyruar të marrin një raport të kredive për cilindo klient që obligohet me kushtet e kredisë, në rrethanat e mëposhtme:
- 2.1. para lëshimit të kredisë;
  - 2.2. me ripërtëritjen ose rritjen e kredisë; dhe
  - 2.3. me ndryshimin e kushteve të kredisë.

## **Neni 10**

### **Shkëmbimi i informacionit të kredive**

Shkëmbimi i informacionit të kredive me institucione përkatëse në nivel ndërshtetëror mund të ndodhë në përputhje me nenin 74 të Ligjit për Bankën Qendrore si dhe ligjet përkatëse të aplikueshme në Republikën së Kosovës, nëse Banka Qendrore ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi apo ndonjë marrëveshje tjetër për shkëmbim të informacionit me një institucion përkatës në atë vend të huaj.

## **KAPITULLI -V - TË DREJTAT E SUBJEKTEVE TË TË DHËNAVE**

### **Neni 11**

#### **Të drejtat e subjekteve të të dhënave**

1. Subjektet e të dhënave ruajnë të drejtën e tyre për privatësi të të dhënave në përputhje me ligjin.
2. Ofruesit e kredive dhe Banka Qendrore do të ofrojnë një përmbledhje të të drejtave të subjektit të të dhënave. Në bazë të kësaj Rregulloreje, me kërkesë të subjektit të të dhënave, kjo përmbledhje së paku do të përfshijë:
  - 2.1. Të drejtën e personit fizik për të marrë një raport të kredive një herë në vit pa pagesë dhe raporte shtesë të kredive kundrejt tarifës të përcaktuar nga Banka Qendrore; të drejtën e entitetit juridik për të marrë raporte të kredive kundrejt tarifës së përcaktuar nga Banka Qendrore;
  - 2.2. Të drejtën e subjektit të të dhënave për të kontestuar informacionin e kredisë dhe/ose të drejtën për të parashtruar ankesë në pajtim me Rregulloren e BQK-së për procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave.
  - 2.3. Të drejtën për privatësi të të dhënave në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.
  - 2.4. Një shpjegim të të gjitha fushave të të dhënave të përfshira në raportin e kredisë.
3. Subjektet e të dhënave do të kenë mundësinë për të kërkuar raporte të kredive nga ofruesit përkatës të kredive ose nga Banka Qendrore. Ofruesit e kredive do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se ata janë në gjendje për të pranuar në mënyrë të duhur kërkesat e subjekteve të të dhënave për raporte të

- kredive. Ofruesit e kredive do të raportojnë kërkesat e subjekteve të të dhënave për raporte të kredive te Banka Qendrore brenda tri (3) dite pune nga pranimi i kërkesave të tilla. Raporti i kredive do të ofrohet për subjektin e të dhënave që bën kërkesë, jo më shumë se pesë (5) ditë pune pas pranimit të kërkesës nga Banka Qendrore.
4. Subjektet e të dhënave do të kenë të drejtë për të kërkuar plotësimin, korrigjimin apo shlyerjen e informacionit të kredive të tyre .
  5. Edhe Banka Qendrore edhe ofruesit e kredive do të njoftohen me kërkesën e subjektit të të dhënave për plotësim, korrigjim ose shlyerje të informacionit të kredisë.
    - 5.1. Subjekti i të dhënave duhet të tentojë fillimisht të zgjidhë kontestin lidhur me informacionin e kredisë me ofruesin përkatës të kredisë duke i parashtruar kërkesën dhe/ose ankesën.
      - 5.1.1. Ofruesi i kredisë do të shqyrtojë dhe përgjigjet në kërkesë për korrigjim, plotësim, shlyerje brenda pesë (5) ditëve pas pranimit të saj, ndërsa në ankesë, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të saj, përfshirë edhe çdo shtyrje të afatit në pajtim me Rregulloren e BQK-së për procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave.
      - 5.1.2. Subjekti i të dhënave do të konfirmojë pajtimin ose mospajtimin me përgjigjen e ofruesit të kredive.
    - 5.2. Nëse zgjidhja sipas paragrafit 5 nën paragrafi 5.1.1. të këtij neni është e pakënaqshme për subjektin e të dhënave, në këtë rast, subjekti i të dhënave mund të informoj me shkrim Bankën Qendrore mbi kërkesën dhe/ose ankesën. Banka Qendrore do ta shqyrtojë rastin dhe do t'i përgjigjet subjektit të të dhënave në pajtim me Rregulloren e BQK-së për procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave.
    - 5.3. Nëse subjekti i të dhënave është i pakënaqur me zgjidhjen përfundimtare nga nën paragrafi 5.2. i paragrafit 5 të këtij neni, dhe/ose nëse kërkesa dhe/ose ankesa e tij/saj nuk është objekt shqyrtimi i BQK-së, subjekti i të dhënave mund të shfrytëzoj mjetet përkatëse juridike të parapara me legjislacionin në fuqi.
    - 5.4. Banka Qendrore do të mbajë të dhëna për të gjitha informacionet e kontestuar të kredive.
  6. Përderisa të mos jepet përgjigja ndaj një kërkesë, raporti kreditor përkatës duhet të ketë një shënim që identifikon informacionin e kontestuar dhe të ndodhur nën hetim, në përputhje me kushtet e udhëzimit përkatës të lëshuar nga Banka Qendrore.
  7. Ky nen nuk eliminon apo zëvendëson kërkesat për shpallje të informacionit të subjektit të të dhënave sipas ndonjë ligji apo rregulloreje tjetër në fuqi.

## **KAPITULLI VI - TARIFAT**

### **Neni 12 Tarifat**

1. Banka Qendrore do t'i ngarkojë ofruesit e kredive me tarifa të arsyeshme për pjesëmarrje në Regjistrin e Kredive dhe për raportet e kërkuara të kredive.

2. Banka Qendrore do t'i ngarkojë subjektet e të dhënave me tarifa të arsyeshme për raportet e kërkuara të kredive, me përjashtim të raportit të kredive që jepet një herë në vit pa pagesë me kërkesë të personave fizikë.

## **KAPITULLI -VII – NDËSHKIMET**

### **Neni 13**

#### **Zbatimi, masat korrigjuese dhe dënimet civile**

1. Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare si dhe Ligjin për sigurime.
2. Shkeljet që mund të rezultojnë me gjoha administrative përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në:
  - 2.1. dështim për të raportuar informacionin e kredive;
  - 2.2. raportim të vonuar të informacionit të kredive;
  - 2.3. raportim të të dhënave të pasakta për kredi;
  - 2.4. keqpërdorim të raporteve të kredive nga ofruesit e kredisë;
  - 2.5. zbulim të paautorizuar të informacionit të kredive.
3. Ndëshkimet e përcaktuara sipas këtij neni nuk përjashtojnë zhvillimin e procesit penal apo civil sipas legjislacionit në fuqi.

## **KAPITULLI VIII - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 14**

#### **Dispozitat kalimtare**

Dispozitat e udhëzimit për regjistrin e kredive të miratuar më 30 prill 2018, të cilat nuk janë në kundërshtim me këtë rregullore, do të aplikohen përshtatshëm deri në nxjerrjen e udhëzimit të ri për regjistrin e kredive.

### **Neni 15**

#### **Publikimet**

Banka Qendrore për qëllime statistikore dhe kërkimore mund të publikojë informacionin e mbajtur në Regjistrin e Kredive tërësisht ose pjesërisht duke garantuar anonimitetin e tij, pa veçuar ofrues të kredive ose kredi marrës të caktuar.



**Neni 16**  
**Udhëzimi**

Banka Qendrore do ta lëshojë një udhëzim për të zbatuar përgjegjësitë e saj sipas kësaj Rregulloreje.

**Neni 17**  
**Shfuqizimi**

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje do të shfuqizohet Rregullorja për Regjistrin e Kredive e miratuar më datë 24 shkurt 2012.

**Neni 18**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës